



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË



Nr. 141/Prot, Datë 12.01.2025

Nr. 3315/1 Prot, Datë 19.12.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

AGJENCISË KOMBËTARE E RINISË

DHE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Agjencia Kombëtare e Rinisë (këtu dhe në vijim referuar si "AKR"), person juridik publik, identifikuar me NIPT L42408451A, me adresë Rr. "Naim Frashëri" Nr. 37, 1000, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, znj. Sara Bodo.

dhe

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë si institucion publik me statusin "Person Juridik Publik" , përfaqësuar nga **Prof. Dr. Aurela Saliaj në cilësinë e Rektorit** si përfaqësuesi ligjor për çështjet akademike dhe protokollare dhe autoriteti më i lartë akademik.

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi midis AKR-së dhe Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë , si dhe zgjerimi i mundësive për ndërmarrjen e iniciativave të përbashkëta me qëllimin inkurajimin e nismave që kanë në fokus studentët/të rinjtë.

1.2 Kjo marrëveshje nënshkruhet me qëllim bashkëpunimin mes institucioneve të sipërpërmendura për sigurimin e kushteve për mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve në vendimarrje si dhe krijimin e mekanizmave për zhvillimin e politikave rinore me fokus në qeverisjen mbi të drejtat e të rinjve, mbrojtjes nga çdo formë dhune, aftësimi për jetën, këshillimi dhe formimi i karrierës dhe nxitje e punëve të denja për të rinjtë dhe ndërlidhjes me tregun e punës, edukimi mjedisor, promocioni dhe edukimi shëndetësor etj., në zbatim dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, politikave dhe programeve të miratuara nga Ministria Përgjegjëse për Rininë, Strategjisë Kombëtare Rinisë 2022-2029 dhe programeve të Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë .

1.3 *Pranojnë* faktin se ky bashkëpunim është një aktor kyç në garantimin e ofrimit të shërbimeve në nivel akademik dhe profesional dhe se Palët kanë disponueshmërinë maksimale për të mbështetur studentët, pedagogët dhe specialistët në fushat përkatëse nëpërmjet programeve dhe metodave praktike të konsoliduar dhe bashkëkohore.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje hartohet në bazë të Kodit Civil në fuqi në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr. 75/2019 “Për Rininë”, i ndryshuar, Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 02.09.2020, “Për Mënyrën e Krijimit, të Organizimit e të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 512, datë 25.9.2025 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 692 datë 26 Tetor 2022 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022-2029” dhe legjislacionit të aplikueshëm në fuqi.

Neni 3

Qëllimi

3.1 Kjo marrëveshje nënshkruhet me qëllim bashkëpunimin në funksion të shkëmbimit të përvojave midis institucioneve, ndjekjen dhe zhvillimin e edukimit formal dhe/ose joformal, veprimtarinë rinore, sociale, kulturore dhe këshilluese të të rinjve.

3.2 Palët synojnë të kontribuojnë dhe në fusha të tjera brenda objektit të veprimtarisë së tyre, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, aktivizmit rinor, zhvillimit të kapaciteteve dhe ofrimit të shërbimeve

mes dy institucioneve, në zbatim të politikave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për rininë si dhe kurrikulave të Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë .

Neni 4

Fushat e bashkëpunimit

4.1 . Palët marrin masat e nevojshme për të krijuar mundësi të reja për studentët dhe të rinjtë si edhe për të përmirësuar veprimtaritë në fushën e edukimit formal dhe/ose joformal, social, kulturor dhe këshillues të të rinjve, duke përfshirë por pa u kufizuar në këto fusha bashkëpunimi:

- a) Planifikimin dhe hartimin e strategjive me qëllim mbështetjen, aktivizimin, fuqizimin dhe promovimin e studentëve/të rinjve;
- b) Bashkëpunim për identifikimin dhe orientimin e politikave për të rinjtë, duke shkëmbyer përvoja, eksperience dhe ide midis institucioneve;
- c) Bashkëpunim në organizimin dhe realizimin e takimeve, konferencave, seminareve, ë workshop-eve, trajnimeve, praktikave të punës, konkurseve, fushatave ndërgjegjëse etj, për përfshirjen dhe ndërveprimin e studentëve/të rinjve në jetën sociale;
- d) Mbështetje institucionale në inkurajimin e nismave, aktiviteteve apo kompeticioneve si dhe iniciativave në interes të përbashkët me fokus studentët/rininë;
- e) Publikime në faqen zyrtare të AKR-së të informacioneve, njoftimeve për projekte kërkimore, studimeve, raporteve, fotografive të aktiviteteve etj;
- f) Ofrimi i burimeve njerëzore dhe financiare për organizimin e iniciativave dhe aktiviteteve të përbashkëta, brenda hapësirave ligjore të AKR-së;
- g) Organizimin e takimeve vjetore të përbashkëta me qëllim paraqitjen e rezultateve të veprimtarisë vjetore të kryer në kuadër të bashkëpunimit institucional.
- h) Zhvillimi i praktikave arsimore/profesionale, internship-eve dhe dual study;
- i) Pjesëmarrja në projekte të financuara që kanë interes të përbashkët;
- j) Organizimi i workshop-eve.

Neni 5

Detyrimet e palëve

5.1 Palët në diskrecionin dhe mbi bazën e dakordësisë mes tyre, marrin masat e nevojshme për të zbatuar aktivitetet e parashikuara në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje si dhe duke krijuar mundësi të reja për të rinjtë më qëllim përmirësimin e veprimtarisë në fushën e edukimit formal dhe/ose joformal, sociale, kulturore dhe këshilluese duke përfshirë por pa u kufizuar në detyrat e mëposhtme:

Përgjegjësit e AKR-së:

- a) Angazhimi dhe kontributi në hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje.
- b) Bashkëpunimi me Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, për fuqizimin e strukturave rinore.
- c) Planifikimi dhe hartimi i strategjive me qëllim mbështetjen, aktivizimin, fuqizimin dhe promovimin e të rinjve.
- d) Bashkëpunimi në organizimin dhe realizimin e takimeve, konferencave, seminareve, punëtorive, trajnimeve, praktikave të punës, konkurseve, aktiviteteve, fushatave ndërgjegjëse etj., për përfshirjen dhe ndërveprimin e të rinjve në jetën sociale.
- e) Mbështetja institucionale në inkurajimin e nismave dhe iniciativave në interes të përbashkët me fokus rininë.
- f) Publikimi në faqen zyrtare të AKR-së të informacioneve, mundësive, njoftimeve, studimeve, raporteve dhe fotografive të aktiviteteve të përbashkëta.
- g) Ofrimi i burimeve njerëzore dhe mundësive sipas hapësirave ligjore e financiare për organizimin e iniciativave dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- h) Shkëmbimin e përvojave, ideve dhe eksperiencave midis institucioneve.

Përgjegjësit e Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë :

- a) Bashkëpunimi me Partnerin në vlerësimin e mundësisë së angazhimit të stafit akademik të Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë në trajnime, sipas rastit, për stafin e Partnerit, sipas nevojave dhe mundësive të Palëve, dhe me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit të Partnerit;
- b) Publikimin në faqen zyrtare të Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë , të informacioneve, njoftimeve, studimeve, raporteve në lidhje me fushat që paraqesin interes për të rinjtë;
- c) Bashkëpunim në organizimin dhe realizimin e takimeve, konferencave, seminareve, workshop-eve, trajnimeve, praktikave të punës, konkurseve, aktiviteteve, fushatave ndërgjegjëse etj. për përfshirjen dhe ndërveprimin e studentëve/të rinjve në jetën sociale;
- d) Shkëmbimin e përvojave, ideve dhe eksperiencave midis institucioneve.

Përgjegjësitë e përbashkëta të Palëve

Palët marrin përsipër së bashku përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) Të sigurojnë bashkëpunim profesional përmes përdorimit të strategjive efikase dhe inkurajuese;
- b) Të afirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të Marrëveshjes (shih Nenin 2, më sipër) për të përmbushur angazhimet e marra;
- c) Të organizojnë grupe të përbashkëta pune për zgjidhjen e çdo problemi që ndikon në bashkëpunimin e tyre;
- d) Të organizojë praktika, studime, kërkime shkencore, aktivitete, konkurse, etj.;
- e) Të shqyrtohet bashkëpunimi në programet e dual study (punë dhe studim);
- f) Të shqyrtohet bashkëpunimi në projektet e duhura të Kërkimit dhe Zhvillimit.
- g) Palët bien dakord të komunikojnë drejtpërdrejt për çdo çështje, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, sipas Nenit 8, më poshtë.

Çdo ndryshim/modifikim i Marrëveshjes do të hyjë në fuqi kur të ketë dakordësi me shkrim nga të dyja Palët.

Neni 6

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

6.1 Afati i Marrëveshjes do të fillojë me nënshkrimin nga të dyja Palët dhe do të vazhdojë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare

6.2 Marrëveshja do të rinovohet automatikisht, për periudha 1 (një) vjeçare, përveç rastit kur ndonjëra nga Palët informon Palën tjetër të paktën një muaj përpara dhe me shkrim, për vendimin e saj për të mos rinovuar Marrëveshjen.

6.3 Palët mund ta ndërpresin Marrëveshjen përpara afatit kontraktual me një marrëveshje të përbashkët me shkrim.

6.4 Marrëveshja mund të ndërpritet në mënyrë të njëanshme në rast se njëra nga Palët nuk përmbush përgjegjësitë e parashikuara në Nenin 4, Nenin 5 dhe Nenin 6. Në çdo rast, njëra nga Palët që konstaton mospërmbushje nga Pala tjetër, duhet t'i komunikojë kësaj të fundit dhe t'i japë një afat kohor prej 1 (një) muaji për të përmbushur përgjegjësitë e Marrëveshjes.

Neni 7

Personat e Kontaktit

7.1 Secila nga Palët cakton një person kontakti, të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin ato me gojë ose me shkrim, elektronike dhe të shtypura në letër. Në momentin e nënshkrimit të Marrëveshjes, personat e kontaktit janë si më poshtë:

Për AKR:

Për Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë:

7.2 Në rast ndryshimi të personave të caktuar për sa cituar, Pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e përfaqësuesit të ri të kontaktit.

Neni 8

Mbrojtja e të dhënave dhe informacionit konfidencial

8.1 Palët garantojnë se të gjitha të dhënat personale të zbuluara në bazë të marrëveshjeve të lidhura do të përpunohen në përputhje me të gjitha parimet dhe dispozitat përkatëse të

Rregullores së (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 27 Prill 2016 mbi Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale dhe Lëvizjes së Lirë të këtyre të dhënave dhe shfrytëzimin e Direktivës 95/46 KE (rregullorja e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave dhe të gjitha detyrimet që rrjedhin prej tyre sipas Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave), Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe legjislacionit relevant.

8.2 Të dyja palët pranojnë të ruajnë informacionin konfidencial dhe të sigurojnë mbrojtjen e tij në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme. Informacioni konfidencial nuk do të ndahet me palë të treta pa lejen e shkruar të palës tjetër.

Neni 9

Pronësia intelektuale

- 9.1 Të gjitha të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të pronësisë intelektuale të lidhura me çdo vepër të krijuar nga secila prej palëve përpara dhe gjatë këtij bashkëpunimi, do të mbeten respektivisht në pronësi të secilës palë.
- 9.2 Për lloje të veçanta produktesh apo krijimtarish të palëve në këtë bashkëpunim, të drejtat e pronësisë intelektuale i përkasin palës përkatës, dhe mund të rregullohen veçmas në marrëveshje të posaçme mes AKR-së dhe Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë .
- 9.3 Palët do të zbatojnë parashikimet e Ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar si dhe legjislacionit të aplikueshëm, për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale.

Neni 10

Shtesa, amendime dhe aneksi/et e Marrëveshjes

10.1 Palët në çdo kohë mund të negociojnë zgjerimin e fushës së veprimit dhe/ose ndryshojnë këtë marrëveshje bashkëpunimi me miratimin e ndërsjellët me shkrim të palëve.

10.2 Anekset bashkëlidhur kësaj marrëveshje kanë të njëjtën fuqi ligjore si marrëveshja në fjalë.

Neni 11

Hyrja ne fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e palëve. Kjo marrëveshje bashkëpunimi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, njëra prej të cilave depozitohet pranë AKR-së dhe njëra depozitohet pranë Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë .

Neni 12

Dispozita të fundit

12.1 Palët, në çdo kohë mund të negociojnë zgjerimin e fushës së veprimit dhe/ose ndryshojnë këtë marrëveshje bashkëpunimi me miratimin e ndërsjellë me shkrim të palëve.

12.2 Kjo marrëveshje bashkëpunimi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, një prej tyre depozitohet pranë AKR-së dhe tjetra depozitohet pranë Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë .

AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Përfaqësuar nga:

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Sara BODO

Sara Bodo S
(Emër, Mbiemër, Firmë)



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE

Përfaqësuar nga:

REKTOR

PROF. DR. AURELA SALIAJ

A. Saliaj
(Emër, Mbiemër, Firmë)

